

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

RAIMONDA ARAPI

RISHKRIMI I VEPRËS SI NJË PROCEDE ARTISTIKE TE KADAREJA

Historia e letërsisë përveç se është historia e jetës së autorëve dhe krijimeve të tyre, ajo nuk mund të kuptohet pa një version të gjithanshëm të gjithë veprave, konkretisht pa një studim të imtësishëm të versioneve (Këtu duhet të kemi parasysh se pjesë e historisë së letërsisë bëhet dhe studimi i faksimileve, prandaj unë e quaj të domosdoshëm studimin e versioneve të veprave letrare). Nevoja e studimit të veprave të rishkruara mendoj se është bërë një domosdoshmëri në studimet letrare. Rishkrimi i veprave ka një diferencim të madh nga një dorëshkrim në tjetrin. Duke u nisur nga ky diferencim mora për të studiuar “Kështjellën” (1970) - “Kasnecët e shiut” (1995) se është ndër veprat më ideologjike të Ismail Kadaresë. “Kështjella” paraqitet me diferenca më të mëdha në rishkrim me ndryshime midis veprave si nga ana e botëkuptimit dhe nga ana stilistikore. Gjatë periudhës së krijimtarisë të Ismail Kadaresë kemi vënë re se në dhjetë vitet e para të demokracisë më tepër, e ne vazhdimësi autori ka pasur një tendencë për të rishikuar veprat e tij dhe njëkohësisht për të ribotuar ato. Për të qartësuar më tepër këtë tendencë të autorit kam shkëputur një moment të bisedës së tij me Alain Bosquet pikërisht nga vepra “Dialog me Alain Bosque”¹ - **Alain Bosquet- ka tekste që nuk ju hiqen nga mendja aq sa i ndryshoni pareshtur? I.K** “.....Dëshira për t’i rishikuar shkrimet e mia, për t’iu rikthyer disa herë për të dhënë disa motërzime të ndryshme më ka shqetësuar dikur ngaqë më dukej si një mungesë e imja. Më pas, duke persiatur për zhdërvillimin (procesin) letrar botëror, zbulova se kjo dëshirë nuk është veçse një rikujtim asaj kohe të largët (kohë e largët, e turbullt dhe plot mister), kur letërsia bënte hapin më të madh të saj të zhvillimit: kalimi nga trajta gojore në atë të shkruar... Mendoj se dëshira për rishkrimin e veprës pas botimit nuk është veçse një rizgjim, një rikthim dhe një qortim i këtij malli të shkruar...”

Pra autori e ndjen si një domosdoshmëri të tijën rishikimin e krijimtarisë së tij, ai mendon se ky rishikim është një plotës i nevojës së tij për art. Duke bërë një krahasim midis letërsisë gojore me letërsinë e shkruar Kadare na e ka dhënë mjaft qartë dëshirën e një krijuesi për të shtuar gjithmonë një ide, për të plotësuar diku një frazë, diku një fjali qoftë edhe një fjalë. Këtu kemi të bëjmë me evoluimin e mendimit të autorit i cili një vepër mund ta shkruajë e ta rishkruajë disa herë për të qartësuar idetë e tij. Dua të ndalem në faktin se Ismail Kadare këtë “rizgjim” të veprave të tij arrin ta përshtatë me mjeshtëri me lexuesin. Në ribotimet e veprave në Francë, vëmë re një përshtatje që ai bën me shijet ekzotike të francezëve, dëshirat e tyre drejt lindjes. Në vepër kemi paragrafë të tërë me elemente seksuale,

¹ *Dialog me Alain Bosque*, f. 184-185.

pjesë të përgjakura, me momente që e paraqesin Shqipërinë pagane ose katolike. Evidentimi i tyre tek vepra “Kasnecët e shiut” e ilustron denjësisht pohimin e mësipërm.

Ja ku kemi një moment lufte të cilin autori na e paraqet aq natyrshëm sa që të duket sikur po ndodh parasysh:

²...Të tjerët vrapojnë si të çmendur midis turmës që hiqej mënjanë e tmerruar, bënë një copë udhë zhargas, ngriheshin prapë, binin, hiqeshin brane, ofshanin, gjersa lëshonin ahmën e vdekjes. Tymi vazhdonte të dilte për mjaft kohë nga kufoma, thua se ishte shpirti që dilte me pahir...

Më poshtë do të citoj dhe një fragment nga “Kasnecët e shiut” ku autori ka paraqitur elemente seksuale të cilat mungojnë tek “Kështjella” 1970:

³...Ia vështroi një copë herë seksin, gati i befasuar nga mungullima e leshnajës, që eunuku s’kishte patur mundësi t’ia hiqte si zakonisht. Me atë hije sipër, seksi i vajzës po i dukej disi i huaj dhe më i dëshirueshëm. Kaq herë kishte thënë me vete se ndoshta s’duhej të binte me femër kur kishte ankth që lidhej me shtetin, por pastaj, i shtyrë, me sa dukej, nga një shpresëz se po të bënte të kundërtën do ta shtypte ankthin, e kapërcente mëdyshjen...

Në veprën “Dialog me Alain Bosque” autori ka sqaruar qartë arsyen e mungesës së elementëve fetarë dhe ne normalisht e kuptojmë dhe e kemi të qartë që ato nuk lejoheshin nga sundimi totalitar i asokohe, por që autori i ka ndërthurur mjaft mirë dhe dendur në ribotimin “Kasnecët e shiut” 1995. Për të vënë në dukje këtë pohim kam shkëputur disa paragrafë dhe leksema

- Paragrafët e rinj, tek “Kasnecët e shiut”

⁴*Nga ndriçimi i paktë i pishtarëve, hijet e kokave të tyre në sipërfaqen e guvës ngjanin si të rrethuara me brerore, nga ata që të krishterët qarkonin kokat e martirëve në kishat e tyre.

⁵*- Flasin shumë për të: e quajnë gjeneralin më të madh të kohës, luan, rimohues, tradhëtar të Islamit dhe i Krishtërimin e kështu me rradhë... - Në shëmbëlltyrën e hyjnisë së tyre, ai rreh ta Krishtëzë Shqipërinë, pra ta bëjë që ashtu si Krishti ajo të ringjallet.

⁶*Një javë më pas, meqë kështjellës sonë i ra fati të pengonte e para dyndjen e tyre, nga kisha e madhe e Shkodrës sollën Koren e Zonjës Shën Mëri, atë që 200 vjet më parë i kishte ndihur mbrojtësit e Durrësit kundër Normadëve. E përhiruam të gjithë Zonjën tonë Hyjlindëse dhe shpirtin e ndjemë më të qetë më të fortë... Pastaj si u falëm e u përfalëm u kthyem në kështjellë. Që nga përgjet i ndoqëm me sy gjersa dolën te Pllaja e Kryqit... Në mëngjesin e 13-qershorit, ndaj të gdhirë ra këmbana e kishëzës.

⁷*Midis saj Kështjella do të ngjante edhe më e zezë, me atë veglën e torturës sipër saj, Kryqin. Për të rrezatuar atë shenjë ai kishte ardhur nga fundi i botës.

⁸*Sado që u lutëm para Kores së Zonjës Shën Mëri e ndjenim se ligështimi po u avitej shpirtit tanë. i zbehtë, si i zbardhur nga tmerrin na dukej kryqi sipër kishëzës... Atje iu përhiria si rrallë Zotit Krisht e Zonjës Shën Mëri...

² Kasnecët e Shiut, f. 93.

³ Kasnecët e Shiut, f. 33.

⁴ Kasnecët e Shiut, f. 171.

⁵ Kasnecët e Shiut, f. 285-286.

⁶ Kasnecët e Shiut, f. 21-22.

⁷ Kasnecët e Shiut, f. 26.

⁸ Kasnecët e Shiut, f. 79.

Rishkrimi i veprës si një procedë artistike të Kadareja

-Leksemat (me kuptim të njëjtë)

“Kështjella”		“Kasnecët e shiut”	
<i>djalli</i>	f. 7-	<i>dreqi</i>	f. 28-
<i>shejtanit</i>	f. 8-	<i>qoftëlargut</i>	f. 28-
<i>shenjë</i>	f. 13-	<i>kryqth</i>	f. 33-
<i>shenja</i>	f. 13-	<i>vija dhe kryqe</i>	f. 34-
<i>shejtanit</i>	f. 42-	<i>i largneshit</i>	f. 71-
<i>konstelacionit</i>	f. 116-	<i>yjesisë</i>	f. 168-
<i>arkitekti</i>	f. 162-	<i>kaurri</i>	f. 226-
<i>tyrbe</i>	f. 163-	<i>tume</i>	f. 227-

Kadareja dhe arti i tij

Ai mund të quhet në mënyrë absolute si një shkrimtar i cili bëri art për art. Për këtë pohim kaq të rëndësishëm ekzistojnë disa argumente:

Së pari- një argument kryesor është se autori ka një tendencë për rishkrimin e veprave të tij, siç na pohon dhe se ai e ndjen të nevojshme që aty-këtu në veprat e tij kërkon të bëjë plotësime, ndryshime *për të kënaqur ndjesitë e tij artistike*. Ai sheh rishkrimin e veprave si një rizgjidhje, si një rizgjim të tijin.

Së dyti-temat e tij janë *mjaft universale dhe globale*. Aftësia për t’u dhënë krijimeve letrare karakter sa global aq dhe universal është një ndër vlerat më të shquara e më origjinale të artit të Kadaresë. Krijimtaria e tij të sugjeron të vërteta universale që të kujtojnë kapituj kryesorë të filozofisë së jetës. Zakonisht në romanet e novelat më të mira të tij filtrohet një koncentrat që vlen jo vetëm për atë kategori personazhesh me të cilët merret, por për gjithë shoqërinë, madje jo vetëm popullin tonë, por përgjithësisht për gjithë njerëzinë mbarë.

Temat e tij përfshijnë konflikte jetësorë si:

- **Njeri-Shtet.** “Dimri i madh”; “Koncert në fund të dimrit”; “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”...etj.

- **Njeri-Fat**- “Kush e solli Doruntinën”; “Brezia e Hankonatëve”.

- **Njeri-Mit-Çmitizim**- “Kështjella”; {“Kasnecët e shiut”}.

Së treti - Tendencë për përdorimin e metaforës gjuhësore është mjaft e theksuar në veprat e Kadaresë, madje mund të themi se metafora është një nga gurët e themelit të gjuhës dhe të stilit të Kadaresë. Metafora është e pranishme si një mënyrë të menduari e të shprehuri dhe përdorimi në shkallë të gjerë i tyre është shenjë e poetizimit të prozës së tij. Mënyrat dhe teknikat e krijimit të metaforave të Kadaresë janë të ndryshme, por më tepër bie në sy përdorimi i metaforave folje ose emër. *Kështu, p.sh. Kryeveqilharxhi thotë se, Kështjella po na shtyp me hijen e saj.*

-Ndërsa me metaforat emër autori arrin t’i japë mendimit më shumë peshë dhe të gjallërojë më tej fantazinë dhe intuitën e lexuesit. Për të treguar qëndresën e shqiptarëve dhe humbjet e mëdha të turqve, kur këta mundën të hyjnë në oborrin e vogël të kështjellës, autori vetëm me një metaforë-emër *“Ishte krijuar qilimi i parë i mishit dhe i gjakut”*, na jep të kuptojmë se çfarë kërdie u bë aty në një shesh beteje - “Kështjella”, {“Kasnecët e shiut”}.

Së katërti. Vëmë re se në ribotimet e veprave të tij Ismail Kadare ka një tendencë të theksuar të pastërtisë së gjuhës ose të kërkimit gjuhësor për elemente të reja që mund të ndërthuren në gjuhën shqipe (Mjaft mirë këtë pohim e kam ilustruar në kapitullin II të studimit tim.). Atje vëmë re se midis “Kështjellës” dhe “Kasnecët e shiut” kemi mjaft fjalë që ndryshojnë. Autori na jep sinonime të fjalëve duke zgjeruar numrin e fjalëve për një kuptim të vetëm. Aty-këtu ai përdor edhe shprehje për një fjalë të vetme. Autori përdor edhe shkurtime fjalësh duke na dhënë një fjalë të vetme. Të gjitha rastet që ju do të lexoni të çojnë në mendimin se çdo ndryshim që autori ka bërë midis dy botimeve, çdo fjalë e hequr, e shtuar dhe e zgjeruar, e kanë shndërruar botimin “Kasnecët e shiut” në një vepër tepër bashkëkohore, përsa i përket perfeksionit në gjuhë dhe në koncepte.

“Kështjella”		“Kasnecët e shiut”	
dëgjonte i habitur	f. 19-	I shqeu sytë nga habia	f. 43-
mushamatë	f. 24-	Shkorsat e zeza	f. 49-
të lashtë	f. 25-	Të kryehershëm	f. 50-
shkatërrimi i shqiptarëve	f. 25-	Gjunjëzimi i Ballkanit	f. 51-
e arrestoi	f. 27-	E vuri në pranga	f. 52-
astrologu	f. 32-	Ëndërrshkoqitësin	f. 60-
e shprehim	f. 34-	E shpërfaqnin	f. 62-
serdengjeshmeler	f. 45-	Ushtar i vdekjes	f. 73-
me gjakftohtësi	f. 54-	Mos e prish gjakun	f. 85-
vijmë rrotull	f. 39-	Zdërhallemi	f. 67-
zonën e ndaluar	f. 54-	Bokërrimën	f. 85-
të holla e të gjata	f. 54-	Gjatuca	f. 86-
me ironi të lehtë	f. 29-	Shpotitëse	f. 53-
për këtë qëllim	f. 46-	Ndaj	f. 74-

Së pesti. Mund të pohojmë në mënyrë absolute se kompozicioni në veprën Kadasë është një element i cili çmohet si një vlerë potencialisht mjaft e pasur. Kompozicionet e shkrimeve të Kadasë ndryshojnë nga njëri-tjetri. Secili prej tyre është një befasi. Për secilin subjekt është gjetur ai më i përshtatshmi. Në përgjithësi kompozicionet e veprave të Kadasë i karakterizon zhdërvjelltësia, përthyerja e një kompozicioni unik, drejtvizor, duke përdorur disa mozaikë kompozicional të harmonizuar brenda një kornize të vetme. Stili i tij gjuhësor e kompozicional është mjaft elitë. Ai nuk pranon asnjë lloj interpretimi nga të tjerët për veprat e tij. Përfundimisht mund të pohojmë se Ismail Kadareja shkruan për hir të artit të vetvetes, **si art për art**, i cili na e vërteton këtë jo vetëm me ato çka pamë më lart, por edhe me gjithë krijimtarinë e tij universale dhe unike.